



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:086316

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05607817

PKR.nr.392/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtarja Sulltane Hoti, kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionistë Avni Sylja dhe Alban Ajvazi, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arxhenita Vokshi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.D për shkak të veprës penale të ricilësuar, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, dhe veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.393/2022 të dt.25.07.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me dt.25.03.2024 në të cilin ishin prezent Prokurori i shtetit A.H, i akuzuari B.D me mbrojtësen e tij av. L.K sipas autorizimit, i dëmtuari G.A, me datë 26.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 18.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.D, nga i ati A..., nënës M..., e gjinisë A..., i lindur me dt....., në Gjakovë, me vendbanim në Lagjen T... rr.“A.R dhe K. i B...”, nr..., me numër personal, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon Saldues, i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim nga data **27.04.2022** deri më datë **26.07.2022**, si dhe në arrset shtëpiak prej datës **26.07.2022** deri më datë **22.09.2022**

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Me datë 27.04.2022, rreth orës 11:55 minuta në rrugën “Norbert Jokli” në Prishtinë, i akuzuari B.D i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit G.A, ashtu që pas një mosmarrëveshje paraprake në komunikacion, derisa i akuzuari ishte me veturen e tij të tipit “Ford” me ngjyrë të zezë, me targa të regjistrimit, me shpejtësi shkon mbrapa e godet të dëmtuarin G... duke e zënë me derë gjysmë të hapur, me ç’rast i njëjti ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë përdredhje të qafës, ndrydhje të indeve të buta në regjionin e krahrorit, regjionin e shpinës, regjionin e brrylit të dorës së djathtë dhe regjionin e gjurit të majtë, dëmtime këto me pasoja të përkohshme të shëndetit sipas ekspertizës mjekoligjore të përpiluar nga eksperti mjeko ligjor Dr. N.U,-

- Me këtë ka kryer veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

II. Në datën e njëjtë si në dispozitivin e I-rë të aktgjykimit, i akuzuari pasi kishte shkuar në Stacionin Policor për të dhënë deklaratë, gjatë kontrolles nga ana e zyrtarve policore, te i njëjti është gjetur një thikë, të cilën armë i akuzuari e ka mbajtur pa autorizim në posedim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr.05/L-022, -

- Me këtë ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve të lartshënuara si dhe neneve 3; 4; 7; 17; 21; 38; 39; 42; 43; 69; 70; 71; 72; dhe 79 të KPRK-së, dhe nenit 358, 359 par.2; 360; 364 dhe 365 të KPPRK-së, të akuzuarit B.D, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

- Për veprën penale, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i shqipton **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muajve**, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak atë nga data 27.04.2022 deri më datë 22.09.2022, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

-Për veprën penale, si në pikën II të këtij aktgjykimi, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i shqipton **Dënim me Gjobë** në shumën prej **një mijë (1000) euro**, të cilin dënim/gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

Konform nenit 79 par.1 të KPRK-së të akuzuarit në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak dhe atë nga data 27.04.2022 deri më datë 22.09.2022, ashtu që një ditë e qëndrimit nën masën e paraburgimit, do t'i barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim, pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, për aq sa janë përcaktuar sipas rregullores së kësaj gjykate, kurse në emër të paushallit gjyqësor obligohet të paguaj shumën prej 100 € (njëqind euro), ndërsa në emër të taksës për Programin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 50€ (pesë dhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari, G.A për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt gjyqësor.

Konfikohet thika e sekuestruar nga i akuzuari me emërtim-përshkrim "Tactical line", si mjet i kryerjes së veprës penale.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, fillimisht ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.393/2022 të dt.25.07.2022, ndaj të akuzuarit B.D për shkak të veprës penale,

Vrasja në tentativë nga neni 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit të akuzuarit iu dha mundësia e deklarimit të tij lidhur me aktakuzën, i njëjti u deklarua i pafajshëm për veprat penale të cilat i viheshin në barrë sipas aktakuzës dhe të njëjtit iu dha mundësia e kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hedhje të aktakuzës.

Gjykata me Aktvendimin PKR.nr.392/22 të datës 25.11.2022 ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave, i cili aktvendim është vërtetuar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1295/22 të datës 16.12.2022.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 30.10.2023, 17.01.2024 dhe datë 25.03.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i shtetit, i akuzuari B.D me mbrojtësen e tij av. L.K sipas autorizimit dhe i dëmtuari G.A.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari në bazë të nenit 319 të KPPRK-së, është udhëzuar me të drejtat e tij ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit të akuzuarit iu dha mundësia e deklarimit lidhur me aktakuzën për veprat, Vrasja në tentativë nga neni 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i njëjti u deklarua i pafajshëm për veprat penale të cilat i viheshin në barrë sipas aktakuzës.

Pasi që i akuzuari u deklarua i pafajshëm për veprat penale të cilat i viheshin në barrë sipas aktakuzës, gjykata vazhdoi me paraqitjen e radhës së provave në shqyrtimin gjyqësor, me fjalën hyrëse të palëve, me dëgjimin e të dëmtuarit-dëshmitarit, me administrimin e provave materiale, me mbrojtjen e të akuzuarit si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se pas shqyrtimit gjyqësor lidhur me aktakuzën PP.I.nr.393/2022 e datës 25.07.2022, gjatë të cilit shqyrtim janë administruar të gjitha provat e propozuara po ashtu u deklarua edhe i dëmtuari/dëshmitari G.A, e me të cilën u vërtetua përtej dyshimit mirë të bazuar se i akuzuari kishte kryer veprat penale të cilat i vihen në aktakuzë. Nga i njëjti është vërtetuar që më herët nuk kanë pasur njohuri mes veti i dëmtuari me të akuzuarin dhe se atë ditë i akuzuari kishte krijuar një perceptim për shkak të problemeve të mëhershme që i kishte pasur me disa persona, se G.A po do t'i bëjë ndonjë të keqe edhe pse në asnjë formë G.A nuk kishte tentuar që t'i bëjë ndonjë të keqe të akuzuarit B..., mirëpo i njëjti vetëm kishte dashur që me veturën e tij për punët për të cilat ishte nisur atë ditë dhe kjo shihet edhe nga inçizimi se nuk kishte bërë ndonjë veprim dhe në kohën kur ishte duke u kthyer me automjetin e vet, e sheh se nuk po njeh atëherë i akuzuari e kishte marrë veprimin e me automjet, shkon mbrapa apo rikferc dhe e kishte goditur veturën dhe të dëmtuarin duke i shkaktuar dhe dëm në automjet dhe lëndime trupore e të cilat rezultojnë në lëndime të lehta, është vërtetuar në shqyrtim gjyqësor se i akuzuari e kishte kryer veprat penale që i vihen në barrë, e gjithashtu dhe në kohën kur kishte shkuar në Stacion Policor i ishte gjetë një armë dhe atë nuk e mohon dhe vet i akuzuari, dhe pasi që u vërtetuan të gjitha rrethanat rënduese që vërtetojnë elementet e veprës penale, Prokuroria e shtetit i propozon gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor por me rastin e matjes së dënimit t'i ketë parasysh si rrethana lehtësuese dhe atë raportin nga Instituti Forenzik i Kosovës, në të cilën vërtetohet se B.D për shkak të përvojave të mëhershme i njëjti e përdor mekanizmin e projektimit me çka i nxitet nevoja për mbrojtje dhe si të tilla edhe i njëjti e nxit situatën për veprën penale për të cilën akuzohet dhe pse nuk kishte pasur asnjë provokim nga i dëmtuari G..., dhe duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese gjykata t'i shqiptojë një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit dhe rehabilitimi i të akuzuarit që në të ardhmen të jetë një person i dobishëm dhe mos të bie ndesh me ligjin.

I dëmtuari G.A në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e perkrah fjalën perfundimtare të prokurorit te shtetit dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.D av.L.K fjalën e saj përfundimtare e ka përgatitur me shkrim dhe të njëjtën e ka elaboruar në pika të shkurtra në të cilën ka deklaruar se akuza është bazuar vetëm në deklaramë boshe të pambështetura në prova të besueshme dhe argumente dhe se aktakuza është ngritur duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në polici dhe në prokurori, e që është e ndryshme nga ajo e dhënë në shqyrtim gjyqësor. E njëjta deklaroi se i pandehuri në deklaratën e tij në prokurori ishte shprehur qartë se në ditën kritike në vendin e quajtur tek Xhambazet kishte hasur në një veturë “Reno”, ngjyrë orange, të cilën e drejtonte një person që nuk e kishte njohur asnjëherë më parë, i cili ka qenë duke lëvizur me një shpejtësi të vogël rreth 20km/orë, dhe se e kishte penguar komunikacionin duke e bllokuar rrugën dhe i njëjti dy herë i kishte rënë burisë që të i njëjti të voziste me shpejtë dhe ta lajmëronte që po e pengon rrugën. I dëmtuari kishte filluar me një start të shtuar në veturën e tij dhe ishte ndalur në një kthesë, kishte dal nga vetuara e tij dhe kishte ardhur në drejtim të akuzuarit duke vrapuar që të njëjtin ta sulmoj, ku aty për aty i akuzuari është ndjerë në panik kishte kapluar frika dhe i njëjti e kishte kthyer veturën rikferc për të ikur. I dëmtuari kishte qenë prapa veturës dhe se i akuzuari e kishte parë të dëmtuarin vetëm kur ka arritur tek dera e pasagjerit në anën e djathtë ku i dëmtuari është munduar ta hap derën dhe se të dëmtuarin nuk e ka parë por për këtë ishte njoftuar nga policia. Dhe sa i përket thikës së gjetur ka deklaruar se i akuzuari e ka pasur për arsye të vetëmbrojtjes. Ka shtuar se prokuroria e ka mbështetur aktakuzën në ekspertizën mjeko ligjore të Dr. N.U të datës 11.05.2022, e ku në bazë të mendimit të ekspertit dëmtimet e konstatuara sipas raporteve mjekësore bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, e duke u bazuar në këtë konstatim me dëmtim të lehtë trupor nuk përmbushen elementet e as figura e veprës penale vrasja në tentativë. E njëjta ka deklaruar se duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit B.A e datës 04.07.2022 vërtetohet se i akuzuari kishte rënë në panik dhe e kishte kapluar frika e nga kjo i njëjti e ka kthyer veturën në rikferc për të ikur dhe nuk kishte dominuar dashja apo tendenca që ta privoj nga jeta të dëmtuarin G.A, si dhe duke u bazuar në raportin e gjendjes mendore të B.D nga Shskuk-së Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të datës 17.06.2022, i njëjti lehtë mund të provokohet dhe të nxisë situata, dhe të njëjtit i është rekomanduar edhe trajtimi psikoterapeutik, me qëllim të menaxhimit të ankthit të krijuar nga mendimet me përmbajtje kërcënuese për ekzistencën e tij. Ka deklaruar se provat me të cilat prokuroria ka mbështetur aktakuzën nuk e bëjnë të besueshme që në veprimet e të mbrojturit të saj të ketë ekzistuar dashja për të kryer veprat penale për të cilat akuzohet, dispozitivi i akuzës nuk është paraqitur në harmoni me nenin 241 pika 1.7 të KPPRK-së, organi i akuzës nuk i ka paraqitur individualimin e veprimeve inkriminuese për të konstatuar se në veprimet e të mbrojturit të saj ka ekzistuar dashja e që në rastin konkret mungon lidhja shkakore në mes veprimeve të të mbrojturit të saj dhe pasojës së shkaktuar, ashtu që në nenin 20 të KPRK-së parashihet se “personi nuk është përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore”. Pra Prokuroria është dashtë në dispozitiv të paraqet saktë dhe qartë çdo veprim me të cilën plotësohet figura e veprës penale “Vrasja në tentativë”, andaj për këto shkaqe aktakuza nuk mund të qëndrojë. Ka shtuar se në veprimet e të akuzuarit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale me të cilat ngarkohet, me çka, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar që i akuzuari të këtë bërë ndonjërin nga veprimet e kërkuara me ligj për t’u përmbushur vepra penale “Vrasje në tentativë”, nga neni 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprës penale “Mbajtja në pronës, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Gjithashtu e njëjta i propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare ex officio të bëjë ricilësimin e veprës penale nga “Vrasje në tentativë” në “Lëndim të lehtë trupor”, ndërsa sa i përket pikës dy të akuzës për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” të refuzohet akuza.

I akuzuari B.D në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësës të tij.

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë në raport me përkrahimin faktik të ngjarjes në aktakuzë dhe cilësimin juridik të veprës penale. Të gjitha këto në raport me nenin 359 të KPPRK-së.

Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, ashtu që në këtë rast ka ndryshuar pjesë të caktuara në përkrahimin e gjendjes faktike edhe atë nga vepra penale, Vrasja në tentativë nga neni 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së e cila vepër penale hyn në kaptullin me numër XVI, e që kanë të bëjnë me veprat penale kundër jetës dhe trupit.

Ashtu që pas procedimit të provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarit dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën në kuptim të nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, kjo gjykatë për të akuzuarin B.D bëri ricilësimin e veprës penale nga Vrasja në tentativë nga neni 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, ngase nuk qëndrojnë elementet e veprës penale nga neni 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjendja e lartë-theksuar faktike, është gjendje të cilën e ka vërtetuar gjykata me rastin e procedimit të kësaj çështje penale dhe provave të saj. Bazuar në këtë gjendje faktike, gjykata ka bërë ricilësimin juridik të veprës penale, nga ai ricilësim i veprës për të cilën është parashruar akti akuzues.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, fillimisht nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të bashkangjitur si dhe provave materiale rezultoi se vepra penale për të cilën akuzohet i akuzuari B.D është kryer me datë “**27.04.2022**” e jo siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës viti 2021. Po ashtu gjykata në bazë të video incizimeve nga Cd-të cilat edhe janë administruar në këtë proces gjyqësor ka bërë precizimin e kohës së kryerjes së veprës penale e që ka rezultuar “**rreth orës 11:55 minuta**” kohë kjo me orë dimërore në videoincizim 10:55 minuta, e gjitha bazuar në gjendjen reale faktike të vërtetuar nga admisnitrimi i provave në shqyrtimin gjyqësor.

Procedura e Provave

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin G.A, mbrojtjen e të akuzuarit si dhe bëri administrimin e provave materiale me shkrim si: Ekspertiza nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Eksperti mjeko ligjor Dr. N.Ui dt.11.05.2022; Ekspertiza nga SHSKUK Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës i datës 17.06.2022; Ekspertiza e komunikacionit dt.04.07.2022; Raporti preliminar analitik mbi shikimin e video-incizimeve dhe CD, Fotoalbumi me fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës; Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve me numër 2022-AB-1170 dt.27.04.2022; Lista e dëshmitëve dhe zingjiri i ruajtjes; CD-e me video incizimeve të marr nga vendi i ngjarjes.

I dëmtuari-dëshmitari G.A në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me të akuzuarin nuk është në lidhje farefisnore, më datë 27.04.2022, rreth orës 12:40, ishte në veturën e gruas dhe se prej rrugës së Dubrovnikut, e deri te kthesa e Xhambazve, minimum në 4 raste i akuzuari i kishte rënë burisë dhe i kishte bërë presion nga mbrapa me makinë, në çdo rast kur kishte dhënë përparësi në zebra, kishte menduar që dikush që po e nje po i bënte presion shoqëror, i njëjti ka deklaruar se ishte me veturën e bashkëshortes që sa e kishin blerë dhe s'mund ta njëjti dikush, pasi që e kishte marrë kthesën tek "varri i Rugovës" e kishte parë që po e ndjek nga prapa, dhe po i binte burisë dhe i njëjti ia qet dorën, ishte ndal dhe ja kishte liruar rrugën dhe ishte skajuar, personi në fjalë ishte ndal dhe e ka sharë me të gjitha fjalët e mundshme, si "ec ma shpejt mos më bëj presion", dhe e ka pyetur a ke diçka personale me të, dhe e ka sharë përsëri. I dëmtuari ka deklaruar se ka filluar të ecë me veturë disa metra përpara, dhe kishte dal nga vetura, për ta qetësuar situatën dhe për të blerë gjësende në market "Natyra". I dëmtuari deklaroi se i akuzuari ishte ndal dhe ju është afruar te vetura nga ana e pasagjerit, ku e ka pyetur se a ke diçka personale me të, i akuzuari nuk kishte fol fare, dhe i dëmtuari kishte menduar që është penduar dhe i njëjti ka vazhduar të kthehet në veturën tij, dhe sapo e kishte hapur derën e veturës, i akuzuari kishte ardhur me shpejtësi marramendëse nga mbrapa, e kishte zënë me derë, ja kishte thyer këmbën e djathtë, dorën e majte dhe brinjët i kishte pasur të shtypura, edhe se në atë moment i kishte rënë të fikët dhe nuk e dinte se çfarë ka ndodhur, para se të vinte Ambulanca disa djem që ishin në kafiteri e kanë ndihmuar, dhe se i akuzuari kishte ikur me shpejtësi me veturë. Ka shtuar se këtë person nuk e kishte parë asnjëherë dhe se emrin e B.D e kishte mësuar në prokurori. Ka shtuar se distanca në mes të veturës së tij dhe të akuzuarit tek "Natyra" mendon se ka qenë afërsisht 20 metra, dhe se e ka godit veturën 2 herë, deklaroi se në spital ka qëndruar 24 orë e pas kësaj është trajtuar nga shtëpia, ku i kishin vendosur gipsin në këmbë për një javë, ndërsa dorën një muaj nuk e ka pasur në funksion, pas ditës kritike nuk ka pasur ndonjë telashe me të akuzuarin.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, i cili dëshminë e tij në të gjitha fazat e procedurës penale e ka mbështetur në atë se me të akuzuarin nuk ishin njohur më pare, ditën kritike e kishte parë që e kishte mbrapa deri sa ishin rrugës dhe se i akuzuari i kishte rënë burisë që i dëmtuari të lëvizte më shpejtë, dhe se i dëmtuari kur ndalet të market "Natyra" për të belrë disa gjëra, në pjesën e vendit ku ka ndodhur ngjarja, i akuzuari ishte ndal me veturën e tij dhe se i dëmtuari i është afruar të akuzuarit te vetura nga ana e pasagjerit dhe e ka pyetur se çka ka, ndërsa nga video incizimi i marrë nga CD-ja në vendin e ngjarjes, nuk shihet askund që i dëmtuari t'i jetë afruar të akuzuarit apo të kenë ndonjë komunikim, pra e gjithë dëshmia e tij nuk parkon me videoincizimet, andaj nga dëshmia e tij gjykata nuk ka mundur të vërtetoi qëllimin/dashjen e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarin G.A, por vetëm faktin se i akuzuari ka lëviz ndërmarr veprimin për lëvizje mbrapa në mënyrë të pakontrolluar dhe me pjesën e pasme të anës së djathtë e godet automjetin e të dëmtuarit tek dera e përparme dhe e pasme e anës së majtë veturë, po ashtu duke e zënë me derë gjysmë të hapur të dëmtuarin dhe i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë përdredhje të qafës, ndrydhje të indeve të buta në regjionin e krahorrit, regjionin e shpinës, regjionin e brrylit të dorës së djathtë dhe regjionin e gjurit të majtë, e kjo dëshmi se i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin gjen mbështetje edhe në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. N.U të datës 11.05.2022.

Gjykata nga të gjitha provat e lartcekura materiale dhe personale gjeti këto rrethane jo kontestuese sa i përket të akuzuarit B.D:

Nuk është kontestuese fakti se i akuzuari B.D me të dëmtuarin G... nuk ishin njohur më parë, dhe se rasti në ditën kritike me datë 27.04.2022 rreth orës 11:55 minuta, në Prishtinë në rrugën "Nobert Jokli", ka ardhur si rezultat gjatë lëvizjes në komunikacion dhe atë lidhur me mënyrën e lëvizjes gjatë rrugës, kjo u vërtetua nga deklaratat e të dëmtuarit e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor si dhe nga deklaratat e të akuzuarit.

Nuk është kontestuese fakti se në ditën kritike në vendin e quajtur tek “Xhambazet” i akuzuari kishte hasur në një veturë “Reno”, ngjyrë orange, të cilën e drejtonte një person që nuk e kishte njohur asnjëherë më parë, kjo u vërtetua edhe deklarimi i të dëmtuarit si dhe nga mbrojtja e të akuzuarit të dhënë në procedurën paraprake.

Gjithashtu për gjykatën nuk është kontestuese as fakti se i dëmtuari ditën kritike ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë përdredhje të qafës, ndrydhje të indeve të buta në regjionin e krahorrit, regjionin e shpinës, regjionin e brrylit të dorës së djathtë dhe regjionin e gjurit të majtë, dëmtime këto me pasoja të përkohshme të shëndetit, e një gjë e tillë vërtetohet edhe nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko ligjor Dr.N.U të datës 11.05.2022.

Gjithashtu nuk është kontestuese as fakti se te i akuzuari B.D sipas raportit të gjendjes mendore është konstatuar se i njëjti lehtë mund të provokohej dhe të nxisë situata, dhe të njëjti i është rekomanduar edhe trajtimi psikoterapeutik, me qëllim të menaxhimit të ankthit të krijuar nga mendimet me përmbajtje kërcënuese për ekzistencën e tij, kjo u vërtetua nga provat materiale si raporti i Shskuk-së- Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të datës 17.06.2022

Faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes të palëve. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen edhe nga dëshmia e dëshmitarit nga deklaratat e të akuzuarit B.D, e gjithashtu kjo u vërtetua edhe nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor siç janë:

Nga Ekspertiza nga Instituti i Mjekësisë Ligjore Eksperti mjeko ligjor Dr. N.U i dt.11.05.2022, rezulton se akt ekspertimi mjeko ligjor pas analizimit të dokumentacionit-pjesë e shkresave të lëndës si në vijim: Raporti mjekësor i lëshuar nga Shskuk-KE-Prishtinë: Nr.26660, datë 27.04.2022, me konstatim: Dg:Distorsia colli; Contusio thoracis et lumbalis; Contusio cubiti lat dex, Contusio geni sin; Në raport të CT nga radiologu nuk përshkruhen ndryshime traumatike; Raporti mjekësor i lëshuar nga Shskuk-Klinika e Radiologjisë-Prishtinë, me konstatim:Dg. udhëzuesue: Susp Fractura radi lat dex; Raporti mjekësor i lëshuar nga QMU-Prishtinë, Nr.50185 i datës 27.04.2022, veç tjerash me konstatim;Dg.Contusio geni lat sin et hemithoracis lat dex, është konstatuar mendimi se tek i dëmtuari G.A dëmtimet e konstatuaranë raportet mjekësore, paraqesin përdredhje të qafës, Ndrydhje të indeve të buta në regjionin e krahorrit, regjionin e shpinës, regjionin e brrylit të dorës së djathtë dhe regjionin e gjurit të majtë, dëmtime këto të shkaktuara si rezultat i veprimt mekanik të mjetit të fortë, mbretës (jo i mprehtë), e të cilat dëmtime të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme në shëndet.

Nga Raporti i Shskuk-Instituti i Psikiatrikë Forenzike të Kosovës 17.06.2022, lidhur me gjendjen mendore të B.D, rezulton konstatimi se: Gjendja psikologjike që ka filluar më herët ka vazhduar të jetë prezente dhe rasti i të qenurit cak i gjendjes me armë para shtëpisë së tij, është një faktor që ka përforcuar edhe më shumë mendimet e përndjekjes dhe bindjes se ekziston dikush që dëshiron t'i bëjë keq. Vlen të theksohet se përvojat e mëhershme kanë ndikuar në formimin dhe mbajtjen e ideve dyshuese dhe frikën e përndjekjes, ku si rrjedhojë i njëjti në mënyrë të vazhdueshme përdor mekanizmin e projektimit me çka në mënyrë automike i nxitet nevoja për mbrojtje edhe në ambiente me stimuj neutral. Rrjedhimisht, i njëjti lehtësisht mund të provokohet dhe të nxisë situata, si kjo e fundit edhe në të ardhmen. Të njëjtit i është rekomanduar trajtim psikoterapeutik që ka për qëllim rritjen e shkallës së insajtit për mekanizmin e projektimit të mendimeve se mund të rrezikohet nga të tjerët dhe menaxhimit të ankthit të krijuar nga intruzioni i mendimeve me përmbajtje kërcënuese për ekzistencën e tij.

Nga Ekspertiza e komunikacionit dt.04.07.2022, rezulton se në bazë të materialit në dispozicion dhe analizave të bëra lidhur me këtë rast është nxjerr konstatimi se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 27.04.2022 rreth orës 12:00, në rrugën lokale “Norbert Jokli” në qytetin e

Prishtinës. Rruga ku ka ndodhur aksidenti i komunikacionit është rrugë lokale dhe mundëson lëvizjen e automjeteve në dy drejtime me nga një shirit për lëvizjen e automjeteve, e drejtë, rruga ku ka ndodhur aksidenti i komunikacionit kalon përgjatë zonës urbane, i shpejtësisë sipas rregullave të përgjithshme të komunikacionit -50km/h. Në ditën kritike moti ishte i mirë, sipërfaqja e rrugës (asfaltit) eterur, periudha kohore ditë, ora 12:00 minuta, dukshmëria e mirë. Para aksidentit automjeti “A” ka qenë duke lëvizur në rrugën lokale “Norber Jokli” edhe drejtuesi më automjet “B” ka qenë duke lëvizur në të njëjtën rrugë dhe drejtim para automjetit “A”. Drejtuesi me automjetin “A” ka qenë duke lëvizur mbrapa me shpejtësi $V_{MAX}=15 \text{ KM/H}$, ndërsa automjeti “B” në momentin kritik ka qenë i ndalur, pra $V_B=0 \text{ km/h}$. Drejtuesi i automjetit “A” ka ndërmarë veprimin për lëvizje mbrapa në mënyrë të pakontrolluar dhe me pjesën e pasme të anës së djathtë e godet automjetin “B” tek dera e përparme dhe e pasme e anës së majtë, si dhe drejtuesin e automjetit “B” i cili ishte duke hipur në automjet. Drejtuesi i automjetit “B” në momentin kritik ka qenë i ndalur për shkak të rrethanave të cilat janë krijuar.

Nga Raporti preliminar analitik mbi shikimin e video-incizimeve nga kamerat e sigurisë në vend ngjarje, rezulton se nga NjHP Prishtinë-2022-AB-1170 datë 20.05.2022, lidhur me rastin janë siguruar video incizime nga dy lokacione të cilat kamera ishin të vendosura që të monitorojnë vendin publik dhe nga kamerat e marra me datë 28.04.2022 nuk vërehet vendi i ngjarjes. Me datë 20.05.2022 rreth orës 09:30 minuta janë siguruar video incizimet nga vendi i ngjarjes dhe shihet ngjarje edhe pse kamerat nuk kanë pamje të qartë pasi që nuk janë mirëmbajtura dhe të papastruara dhe këto kamera kanë orën me kohë të zonës së dimërore, e sipas kohës së kamerave vërehet se i dëmtuari vjen në ora 10:55:01 të datës 27.04.2022 dhe ndalon ku nga pas i vjen vetura e dyshuar e cila fillimisht e kalon veturën e të dëmtuarit, kjo veturë ndalon dhe vazhdon ngasja mbrapa duke e goditur të dëmtuarin në veturë dhe më pas i dyshuari vazhdon dhe largohet nga vendi i ngjarjes ku kjo ngjarje ka zgjatur për disa sekonda.

Nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes-Njësia e Forenzikës në Prishtinë-2022/192 i datës 27.04.2022, rezulton se me datë 27.04.2022 rreth orës 12:50 minuta janë informuar nga AC Baza se në rrugën “Norbert Jokel” Prishtinë ka ndodhur rasti “Vrasja në tentativ” së bashku me hetuesin kanë bërë egzaminimin e vendit të ngjarjes, ku në vendin e ngjarjes kanë prezantuar polici i krim teknikës kriminalistike, hetuesi dhe njësia patrulluese. Kanë filluar me (këqyrjen) e vendit të ngjarjes i cili kishte ndodhur në rrugë. Në vend të ngjarjes në kryqëzimin e rrugës “Norbert Jokel” dhe rrugës “Ibrahim Pacolli”, është hasur një veturë të ndalur në drejtim të veriut. Vetura ishte renault ngjyrë kafe me tabela në krahun e majtë të veturës dy dyert ishin të dëmtuara nga një veturë tjetër, në tokë te pika goditese e veturës kishin mbetur pjesë të dritës së pasme të veturës që kishte ikur nga vendi i ngjarjes. Është bërë fotografimi i vendit të ngjarjes me parat digjital dhe atë fografim i gjërë, i mesem dhe i detajuar si dhe janë marrë dëshmitë nga vendi i ngjarjes dhe atë dy pjesë të dritës së pasme të veturës dhe se këtij raporti i është bashkangjitur fotoalbumi i vendit të ngjarjes.

Nga Foto albumi me fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihen automjeti “Ford” me targa të regjistrimit të cilin ka qenë duke e drejtuar B.D, i cili automjet ka dëmë materiale në pjesën e pasme të anës së djathtë dhe automjeti “Renault Captur” me targa të regjistrimit të cilin ka qenë duke e drejtuar G.A, i cili automjet ka dëmë materiale në anën e majtë tek të dy dyert e majta.

Nga Lista e dëshmimeve dhe zingjiri i ruajtjes nga Njësia e Forenzikës në Prishtinë AF/4.5.4, Njësia e hetimeve AC-4.3.1 si dëshmi rezulton një thikë xhepi, dhe se vendi i gjetjes tek i dyshuari B.D, Libreza e veturës një çelës i veturës me mbishkrim “Ford” të gjetura tek i dyshuari B.D. Pastaj dy (2) pjesë xhami të dritës së pasme të veturës, këto në vendin e ngjarjes.

Nga Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve me numër 2022-AB-1170 dt.27.04.2022, rezulton se nga i akuzuari është sekuestruar një thikë me përshkrim Tactical line, pa numer serik.

Nga Shikimi i video incizimeve të CD-ës (e cila është me orë dimërore) të marr nga kamerat vendi i ngjarjes, video incizime nga dy lokacione të cilat kamera ishin të vendosura që të monitorojnë vendin publik edhe pse nuk kanë pamje të qartë pasi që nuk janë të mirëmbajtura, mirëpo shihet se rreth orës 11:54:47 minuta (10:54:47 orë dimërore) vjen dhe ndalon i dëmtuari me veturën “Reno” më datë 27.04.2022, ku më pas i vjen i akuzuari me veturë e i cili fillimisht e kalon veturën e të dëmtuarit, kjo vetura ndalon dhe vazhdon ngasjen mbrapa duke e goditur të dëmtuarin në veturë dhe më pas vetura “Ford” vazhdon dhe largohet nga vendi i ngjarjes e cila zgjat disa sekonda. Sipas Cd-së shihet kur i dëmtuari me veturën “Reno” ndalet, skajohet, del nga vetura, e kalon me veturë i akuzuari dhe ndalet. Derisa i dëmtuari vazhdon me shku për të hipur në veturë, i akuzuari derisa ishte para të dëmtuarit ndërmer veprim nga mbrapa dhe e godet.

Nga Informacionet për të kaluarën kriminale rezulton se në emër të të akuzuarit B.D në cilësi të dyshuarit janë të evidentuara disa vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme

I akuzuari B.D, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 25.03.2024, pas udhëzimit me të drejtat nga ana e Gjykatës dhe pas konsultimit me mbrojtësen e tij ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore që të mbrohet në heshjte, ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në prokurori më datë 16.05.2022 ka deklaruar se më datë 27.04.2022 rreth orës 12:43 në rrugën “Norbert Jokli” në Prishtinë kishte qenë duke shkuar në shtëpi, dhe vetura e të dëmtuarit kishte qenë me një shpejtësi të ngadalshme as 20 km/orë, dhe i njëjti i kishte rënë borisë së veturës dy herë pasi që ishte me shpejtësi shumë të ngadaltë, kur ishte afruar tek kthesa, i dëmtuari e ka rritur shpejtësinë e veturës, ishte parku dhe i kishte ndez katër shenjat e veturës, ku aty i akuzuari deklaroi se kishte menduar se po e ja liron rrugën për të kaluar, por i dëmtuari kishte dal nga vetura e tij dhe ishte afruar tek vetura e të dëmtuarit dhe ishte munduar me hap derën e pasagjerit, por i akuzuari kishte ec me veturë për të ikur, mirëpo i njëjti ka deklaruar se nga paniku prej rrugës së bllokuar, ishte kthyer rikferc për të ikur, kurse i dëmtuari kishte qenë prapa veturës së tij dhe e kishte goditur atë dhe veturën e tij, pasi e kishte parë në pasqyre të veturës duke e ndjekur i akuzuari kishte ikur. Kurse sa i përket thikës e cila i është gjetur të akuzuarit, i njëjti ka deklaruar se si familje merren me peshkim dhe se e kishte futur në xhep atë thikë pasi që është frikësuar se po i bën dikush keq pas këtij problem. I akuzuari ka deklaruar se nuk kishte për qëllim për ta dëmtuar apo për ta privuar nga jeta të dëmtuarin.

Gjykata në raport me këtë çështje penale dhe aktin akuzues të parashtruar në këtë çështje penale, për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale, cilësimin juridik të veprës penale në raport me gjetjet të cilat kanë rezultuar me administrimin e provave në këtë çështje penale, e gjithë kjo bazuar në gjendjen faktike konsideron se gjetjet gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e kanë vërtetuar veprën penale Vrasja në tentativë të përcaktuar sikurse në nenin 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, mirëpo ka vërtetuar se në rastin konkret i akuzuari ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Gjykata në prezencën e këtyre provave nuk gjeti asnjë provë e cila e lidh të akuzuarin me veprën penale, pasi që nuk janë përmbushë elementet e veprës penale për të cilën i akuzuarit akuzohet. Deklarimi i organit të akuzës se është kryer vepra penale e vrasjes në tentative nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ishte vetëm dyshim i cili nuk ka mbështetje në asnjë provë të besueshme-relevante, pasi që në vrasjen me dashje autori dëshiron që ta vras viktimën. Në rastin konkret gjykata në bazë të provave të administruara, ka vërtetuar se nuk ekzistonin elementet e veprës penale nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, pasi që nuk plotësohen elementet

inkriminues si “dashja-qëllimi, pasoja”, pra për të arritur në përfundim se ku drejtohet dashja e autorit merren parasysh rrethanat subjektive dhe objektive.

Gjykata duke vlerësuar pretendimet e prokurorisë ku kishte pretenduar se i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, gjithnjë mbi bazën e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor, ka analizuar veprimet e të akuzuarit dhe mbi bazën e këtyre provave gjykata nuk ka mundur të vërtetoi faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, mirëpo i njëjti ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar 1.4 të KPPK-së, ndryshimi i mësipërm sa i përket veprës penale bëhet i domosdoshëm sepse ka rezultuar e provuar se për asnjë moment i akuzuari nuk ka pasur si qëllim vrasjen e të dëmtuarit, dhe mbi këto fakte gjykata bëri rikualifikimin e veprës penale.

Andaj trupi gjykues bazuar në nenin 359 par 2 të KPPRK-së ka ri kualifikuar veprën penale ashtu që ka vlerësuar se në veprimet e të pandehurit B.D manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale ëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së, të përshkruar tani si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë çështje penale kontestuese ka qenë fakti se tani i akuzuari B.D në ditën kritike me veprimet e tij a kishte qëllim dhe dashje për ta privuar nga jeta tani të dëmtuarin, G.A.

Më rëndësi është të theksohet se këto elemente a janë plotësuar në rastin konkret, respektivisht në veprimet e të akuzuarit në këtë çështje penale.

Gjykata vlerëson se në këtë çështje penale nuk është vërtetuar dashja e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, nga fakti se i akuzuari ditën kritike në vendin kritik me automjetin e tij ndërmer veprim për lëvizje mbrapa dhe e godet të dëmtuarin dhe veturën e tij, përkundër faktit që ishte shumë afër me të dëmtuarin dhe mund ta godiste prap të dëmtuarin, dhe po ta kishte qëllimin dhe dashjen për ta privuar nga jeta e të dëmtuarit sigurisht që veprimet nuk do t'i ndalte me një goditje dhe nuk do largohej menjëherë, e kjo u vërtetua edhe nga provat materiale dhe video incizimi ku shihet se i akuzuari derisa ishte me veturën e tij para të dëmtuarit lëviz mbrapa dhe e godet të njëjtin, dhe menjëherë vazhdon lëvizjen para duke u larguar nga vendi i ngjarjes. Po ashtu i njëjti në ditën kritike nuk kishte bërë asnjë përgatitje, zgjedhje mjetesh, plan për kryerjen e vrasjes/tentativë apo diçka të ngjashme, dhe se e gjitha ka ndodhur si pasojë e një mosmarrëveshje në komunikacion lidhur me shpejtësinë e lëvizjes dhe në mungesë të këtyre rrethanave dhe konkretisht mendimet e ekspertit mjeko ligjor, gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale, në veprën penale lëndimi i lehtë trupor, ngase nga provat e administruara ka rezultuar se në veprimet e të akuzuarit ishin përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të ri kualifikuar, Lëndimi i lehtë trupor neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, ngase veprimi i të akuzuarit në ditën kritike, pra goditja me automjet me lëvizje nga mbrapa dhe largimi i tij i menjehershëm ka qenë për t'i shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit, e jo ta ketë goditur dy herë duke shkuar mbrapa ashtu siç ka deklaruar i dëmtuari, pretendim ky i cili ishte në kundërshtim me video incizimin nga Cd-ja, dhe se nuk ka ekzistuar dashja e të akuzuarit për të privuar nga jeta të dëmtuarin.

Mbi gjendjen faktike të konstatuar më lartë, gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, për shkak se nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale vrasja në tentativë nga neni 172 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, pasi që nga provat e administruara nuk kanë rezultuar si të provuara tiparët e kësaj veprë penale të cituar më lartë dhe nuk kanë qenë të përshkruara veprimet inkriminuese në dispozitiv të aktakuzës që do të përbënin figurën e veprës penale për të cilën është akuzuar i akuzuari.

Andaj, nga arsyet e lartcekura dhe pas analizimit dhe vlerësimit të provave një nga një e të ndërlydhura me njëra tjetrën, gjykata arriti në përfundim se nga provat e administruara nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në aktakuzë, ngase në bazë të fakteve dhe provave të argumentuara është vërtetuar se në veprimet e të pandehurit plotësohen tiparet e veprës penale të ricilësuar Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme bazuar në faktet dhe provat e lartshënuara konstatoi gjendjen si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe gjeti se në veprimet e të akuzuarit B.D janë konsumuar elementet esenciale të veprave penale të lartcekura, pasi që më parë gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimet e parapara ligjore të precizuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Sa i përket fajësisë së të akuzuarit ka qenë i vetëdijshëm për veprën penale dhe pasojën. Ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata lidhur me pretendimet e mbrojtëses të akuzuarit B.D av.L.K të paraqitur në fjalën përfundimtare, lidhur me pikën II të aktakuzës e cila ka pretenduar se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ngase nuk janë përmbushur elementet e kësaj veprë penale, dhe ka propozuar që të refuzohet akuza, gjykata vlerëson se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme, dhe në kundërshtim me provat e proceduara në këtë çështje penale të konstatuara si më lart.

Gjykata një mbrojtje të tillë e ka vlerësuar si jo objektive, jo reale, në kundërshtim me të gjitha provat materiale, pasi që edhe vet i akuzuari e ka pohuar se ditën kritike e ka poseduar thikën, të njëjtin e kishte futur në xhep, e cila thikë është konfiskuar nga Policia, andaj një mbrojtje të tillë të paraqitur nga i akuzuari dhe mbrojtësja e tij, trupi gjykues e ka vlerësuar si një përpjekje dhe qëllim për t'i ju shmangur përgjegjësisë penale dhe akuzës e cila i vihet në barrë.

Gjykata, pretendimet e theksuara si më lartë nga mbrojtësja e të akuzuarit, i ka vlerësuar si të pabazuara, të pa mbështetshme në asnjë provë të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjithashtu këto pretendime nuk gjejnë mbështetje as në provat materiale pjesë e shkresave të lëndës. Gjykata duke vlerësuar me ndërgjegje të gjitha provat e vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lartë gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin për veprat penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, pasi që gjykata gjeti se i njëjti është përgjegjës dhe fajtor dhe janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprave penale të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin B.D gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh, sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, raportin nga Instituti Forenzik të Kosovës, në të cilën vërtetohet se B.D për shkak të përvojave të mëhershme i njëjti e përdor mekanizmin e projektimit me çka i nxitet nevoja për mbrojtje dhe si të tilla edhe i njëjti e nxit situatën për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti natyrën e veprës penale përfshirë lëndimet që i ka shkaktuar të dëmtuarit, peshën e rëndë të këtyre veprave penale, karakteristikat personale të të akuzuarit dhe sjelljen e mëparshme të akuzuarit dhe duke i peshuar të gjitha këto rrethana dhe duke vepruar në

interes të zbatimit të duhur të drejtësisë, gjykata i ka shqiptuar dënimin ndaj të akuzuarit dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj si dhe dënim me gjobë në shumën prej një mijë (1000) euro, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se këto dënime janë adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këto dënime do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se këto dënime janë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenin 69 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimet e tilla do të ndikojnë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojnë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe 2.9 të KPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të taksës për Programin e Kompensimit e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.2 të Ligji nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi lidhur me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe masën e arrestit shtëpiak është marrë konform nenit 73 par.1 të KPK-së.

Gjykata konform nenit 462 par.2 të KPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit udhëzohen në kontest civil.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.392/22 datë 18.04.2024**

**Zyrtare ligjore
Arxhenita Vokshi**

**Kryetarja e trupit gjykues,
Sulltane Hoti**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.